



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.99/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Salus Haus” me seli ne Gjermani, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson “...” shpk, me adresë ne Prishtinë, ndaj debitorit “Fan Farm” shpk, me seli ne Prishtinë, me nr. Biznesit ..., te cilin sipas autorizimit e përfaqëson M. Sh. avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2044/19 dt.14.03.2022, me datën 30.10.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Salus Haus” me seli ne Gjermani, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Vokshi&Lata” shpk, me adresë ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2044/19 dt.14.03.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.2044/19 dt.14.03.2022, e ka aprovuar prapësimin e debitorit “Fan Farm” shpk, me seli ne Prishtinë, me nr. Biznesit 810816382, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.983/19 dt.11.10.2019, të Përmbaruesit Privat Ilir Mulhaxha, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, ndërsa shfuqizon urdhrin përmbarimor P.nr.983/19 dt.11.10.2019.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes thelbësore te dispozitave procedurale, vërtetimit te gabuar apo jo te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ashtu qe te refuzohet prapësimi i debitorit apo aktvendimi i atakuar te anulohet dhe çështja te kthehet ne shkallë te parë ne rigjykim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Salus Haus” me seli ne Gjermani, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Vokshi&Lata” shpk, me adresë ne Prishtinë, me datën 11.10.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Fan Farm” shpk, me seli ne Prishtinë, me nr. Biznesit 810816382, në bazë të dokumentit përmbartimor – Aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike IE.nr.172/19 dt.19.09.2019. Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.983/19 dt.11.10.2019, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori qe te ndalon shitjen apo çfarëdo tregtimi te produkteve me mbishkrim FLORADISH dhe te gjitha produktet e shitura me mbishkrim FLORADISH neper pikat e shitjes ne Kosovë ti largon nga tregu.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 21.11.2019, duke theksuar se e ka respektuar ne përpikëri Masën e Përkohshme te Sigurimit te lëshuar nga Gjykata Themelore ne Prishtine-Departamenti për Çështje Ekonomike ek.NR.173/19, pa e iniciuar procedurën e përmbartimit edhe pse ajo nuk është e plotfuqishme sepse ndaj atij aktvendimi është paraqitur ankesë ne Gjykatën e Apelit. Shton se debitori vullnetarisht e ka përmbushur obligimin ashtu qe nuk e obligohet për shpenzimet e përmbartuesit.

Ndaj prapësimit te debitorit, me datën 21.11.2019, kreditori ka parashtruar përgjigje, duke arsyetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit ne prapësim sepse debitori nuk e ka njoftuar as kreditorin e as gjykatën se është duke e respektuar aktvendimin e gjykatës, i njëjti edhe kishte ushtruar ankesë ndaj këtij aktvendimi, debitori ka dështuar qe brenda afatit partitiv ta njoftoi gjykatën dhe kreditorin për zbatimin e masës, por propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si dhe te obligoj te njëjtin qe te paguaj shpenzimet e përgjigjes ne prapësim ne vlerë prej 312 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.20448/19 dt.14.03.2022, me të cilin e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin ne bazë te aktvendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.172/2019 dt.19.09.2019, me te cilin është ndaluar këtu debitori qe te importon, shes apo çfarëdo forme te tregton me produkte me mbishkrim Floradish dhe te gjitha prodhimet me firmën Floradish t’i largoj nga tregu. Përkitazi kësaj çështje gjykata vlerëson se kreditori para se te inicioj procedurën përmbartimore është dashur ti drejtohet debitorit me shkresë dhe te kërkoj nga i njëjti informacion nëse është duke e respektuar përkatësisht zbatuar masën e përkohshme dhe nëse debitorit nuk ishte përgjigjur atëherë te iniciohet procedura përmbartimore.

Ne rastin konkret kreditori pretendon se debitori ka dështuar ta informoj kreditorin dhe gjykatën se është duke përmbushur obligimin e tij dhe i njëjti përveç kësaj ka paparaqitur ankesë ndaj aktvendimit për caktim të masës së përkohshme mirëpo gjykata gjeti se debitori me aktvendimin në fjalë nuk ka qenë i detyruar që ta njoftoj kreditorin apo gjykatën se është duke e përmbushur obligimin ndaj tij dhe se fakti se debitori ka paraqitur ankesë ndaj aktvendimit për masë të përkohshme nuk do të thotë që i njëjti nuk ka respektuar masën e përkohshme, andaj në bazë të nenit 71 par.1 nenpar.1.2 të LPP dhe se meqë nuk ka qenë kontestuese se debitori e ka përmbushur në mënyrë vullnetare obligimin e paraparë në dokumentin përmbarues, gjykata vlerëson se dokumenti përmbarues sa i përket këtij rasti përmbarimor e ka humbur efektin juridik, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës së shkalles së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe kjo gjykatë, vlerëson se Përmbaruesi Privat e ka caktuar përmbarimin përmes urdhri P.nr.983/19 dt.11.10.2019 mirëpo nga shkresat në lëndë nuk ka ndonjë provë ose veprim që dëshmon se ka kërkuar nga kreditorit sqarime paraprake se debitori ka përmbushur apo jo obligimin që rrjedh nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.172/2019 dt.19.09.2019, i cili aktvendim në rastin konkret është dokument përmbarues, sipas nenit 22 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, 21 dhe neneve 24 dhe 27 të LPP.

Sa i përket pretendimeve të palës kreditore se debitori nuk e ka zbatuar aktvendimin për caktimin masës së përkohshme sepse i njëjti nuk e ka njoftuar as gjykatën e as kreditorin se është duke e zbatuar këtë masë, kjo gjykate vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron sepse sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së përkohshme, gjykata nuk e obligon debitorin që i njëjti të njoftoi gjykatën apo kreditorin se është duke e përmbushur obligimin tij. Po ashtu bazuar në procesverbalin e datës 14.11.2019 i përpiluar nga Përmbaruesi Privat, për shkak të zbatimit të masës së përkohshme, gjeti se debitori është duke e respektuar masën e përkohshme, sepse përmbaruesi privat në fq. 2 të këtij procesverbali, në paragrafin e fundit, konstaton se *pasi përfaqësuesi i kreditorit nuk ka vërejtje dhe po vërtetohet se debitori po e respekton masën e përkohshme, me qëllim të përfundimit të kësaj lende kërkon nga debitori në afat prej 7 ditësh të paguan shpenzimet përmbarimore.* Andaj bazuar në këto arsye edhe kjo gjykate vlerëson se pretendimet e kreditorit se gjykata në aktvendimin e saj ka bërë shkelje të dispozitave procedurale si dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, janë pretendime të pabazuara, të paargumentuara

dhe jo relevante për një vendosje ndryshe prandaj edhe vendosi që të njëjtat të refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.99/23, me datë 30.10.2023**

**Gjyqtari,  
Dren Rogova**